



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK


Nr. 248.Prot.

Rrogozhinë, më 16.01.2026

NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Enjte datë 22.01.2026 ora 11:00^{oo}**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.12, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 24.12.2025.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2026 nga fondi i pushtetit vendor”.
Materialet e pikës 3 dhe 4 do ju vihen në dispozicion ditën e Martë datë 20.01.2026, pasi për arsye të mosfunksionimit të sistemit kanë mbetur pa u përgatitur.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për “Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”.
- 6- Miratimin i projekt - vendimit, “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2027-2029 dhe buxhetit vjetor”.
- 7- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.
- 8- Miratim i projekt - vendimit, “Për zëvendësimin e vakancave të krijuara në komisionet e këshillit bashkiak”.
- 9- Shqyrtim i situatës së krijuar nga përmbytjet e ndodhura gjatë muajit Janar 2026, në territorin e bashkisë Rrogozhinë.
- 10- Shqyrtim i dy kërkesave të anëtares së këshillit bashkiak znj. Silvana Aliu.
Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 24.12.2025.
- 11- Të ndryshme.
 - *Shqyrtim i shkresës së Ministrisë së Financave, mbi mosrespektimin e kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.*
 - *Të tjera.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- Njoftoj të mbledhet ditën e Martë datë 20.01.2026 ora 13 : 00^{oo}, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla - Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej - Anëtar.
- Njoftoj të mbledhet ditën e Martë datë 20.01.2026 ora 14 : 00^{oo}, Komisioni Juridike, Rend, Konflikte, me këtë përbërje : Indrit Dedej - Zv. Kryetar, Mitat Daja - Anëtar, Lulzim Hasa - Anëtar, Renato Kalemi - Anëtar, Merilin Saraçi Anëtare.

Shënim : Cilido komision tjetër që e konsideron të arsyeshme për t'u mbledhur dhe për të shqyrtuar një apo disa pika të rendit të ditës është i lutur të kordinojë me Sekretarin e Këshillit Bashkiak.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI